



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 8 dhe 14 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 7 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës, nenin 11, 12 14 dhe 16 të Rregullores (ZKA) 02/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës; Vendimit nr. 1667 të datës 22.10.2024, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM **për plotësimin e vendeve të lira të punës**

1. Pozita: Drejtor i Departamentit të Auditimit financiar dhe pajtueshmërisë – shtatë (7) pozita

Numri i referencës:	DDAFP/ZKA/09-10/24
Kohëzgjatja e emërimit:	Tre (3) vjet
Klasa/koefficienti:	B5-12
Raporton tek:	Auditori i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1.1. Kryen auditime sipas Planit Vjetor të Auditimit, në përputhje me SNISA, aktet e brendshme të ZKA, doracakët e auditimit dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
- 1.2. Hartojnë plane dhe programe individuale të auditimit;
- 1.3. Planifikojnë në mënyrë të hollësishme afatet e nevojshme kohore për kryerjen e aktiviteteve të planifikuara;
- 1.4. Bëjnë rishikimet, vlerësimet dhe ekzaminimet e pasqyrave financiare vjetore nëse ato janë të sakta dhe paraqesin gjendjen e vërtetë dhe të drejtë financiare të entitetit të audituar;
- 1.5. Bëjnë ekzaminime për të verifikuar nëse llogaritë paraqesin gjendjen reale dhe transaksionet janë në pajtim me legjislacionin dhe rregulloret financiare;
- 1.6. Bëjnë rishikimin e vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për të siguruar nëse ato janë të dizajnuara mirë, janë të përshtatshme dhe operojnë në mënyrë efektive;
- 1.7. Komunikojnë gjetjet e auditimit në fazën e draft raportit me subjektet e audituara;
- 1.8. Hartojnë raporte të auditimit, duke i propozuar Auditorit të Përgjithshëm opinionin e auditimit nëse pasqyrat financiare paraqesin gjendjen e drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe shpalosjet janë adekuate si dhe konkluzionin/opinionin për pajtueshmëri;
- 1.9. Zbatojnë të gjitha standardet e cilësisë të përcaktuara me Udhëzuesin për Kontrollin e Cilësisë në Auditim, gjatë të gjitha fazave të auditimit;
- 1.10. Monitorojnë në mënyrë sistematike planet e veprimit dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga entitetet e audituara;
- 1.11. Marrin pjesë aktive në hartimin e Raportit Vjetor të Auditimit dhe Raportit Vjetor të Performancës, duke ofruar kontributet e kërkuara nga fushat përkatëse;
- 1.12. Zbatojnë të gjitha rregulloret, udhëzimet, politikat dhe procedurat e brendshme të përcaktuara nga ZKA;

- 1.13. Raportojnë në baza të rregullta për progresin dhe sfidat eventuale në procesin e auditimit dhe realizimin e planeve operative;
- 1.14. Raportojnë lidhur me rezultatet dhe ndikimin e punës në kuadër të departamentit; dhe
- 1.15. Me kërkesën e Auditorit të Përgjithshëm, kryejnë edhe punë të tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- **Arsimimi:** Diplomë fakulteti ose master në ekonomi, juridik, administratë publike ose Inxhinierisë;
- **Përvoja Profesionale:** Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre se paku 5 vite në auditim të jashtëm, prej tyre tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- **Certifikimi:** Të jetë Auditor i certifikuar ose Auditor i certifikuar i sektorit publik.

2. Pozita: Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës – një (1) pozitë

Numri i referencës:	DDAP/ZKA/10-10/24
Kohëzgjatja e emërimit:	Tre (3) vjet
Grada:	B5-12
Raporton tek:	Auditori i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1.1. Harton dhe zbaton planin strategjik për auditimet e performancës, në përputhje me objektivat dhe prioritetet e përgjithshme të ZKA-së;
- 1.2. Kryen auditime të performancës sipas Planit Vjetor të Auditimit, në përputhje me SNISA, aktet e brendshme të ZKA-së, doracakët e auditimit dhe legjislacionin përkatës në fuqi, duke ekzaminuar një aspekt të veçantë të aktiviteteve, në tërësi ose të pjesshme, të ndonjë institucioni, programi, fushëveprimi apo aktiviteti për të vlerësuar ekonomin, efikasitetin dhe efektivitetin;
- 1.3. Kryen parastudimin e auditimit duke përfshirë përcaktimin e objektivave, fushëveprimit dhe kriterëve për çdo auditim si dhe krijimin e maricës së dizajn -matricën e auditimit;
- 1.4. Kryen studimin kryesor të auditimit, duke mbledhur dhe analizuar të dhëna nga burime të ndryshme, përfshirë intervistat, anketat, rishikimet e dokumenteve dhe vëzhgimet në terren;
- 1.5. Komunikon gjetjet e auditimit në fazën e draft raportit të subjektit të audituar;
- 1.6. Përgatit raporte të auditimit të bazuara në dëshmi që dokumentojnë gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet.
- 1.7. Monitoron në mënyrë sistematike planet e veprimit dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga entitetet e audituara dhe raportojnë progresin;
- 1.8. Zbaton procese të sigurimit të cilësisë për të siguruar që auditimet plotësojnë standardet dhe udhëzimet profesionale, të tilla si ato të përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA shqip INTOSAI);
- 1.9. Merr pjesë ose lehtëson rishikimet ndër-departamente për të vlerësuar cilësinë e parastudimeve dhe raporteve të auditimit;
- 1.10. Ofron mbështetje në hartimin e Raporteve Vjetore të Auditimit dhe Raportin Vjetor të Performancës;
- 1.11. Zbaton të gjitha rregulloret, udhëzimet, politikat dhe procedurat e brendshme të përcaktuara nga ZKA;
- 1.12. Raporto në baza të rregullta për progresin dhe sfidat eventuale në procesin e auditimit dhe realizimin e planeve operative;
- 1.13. Raporton lidhur me rezultatet dhe ndikimin e auditimeve të performancës; dhe
- 1.14. Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë të tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës në auditimet e performancës dhe të prokurimit janë:

- **Arsimimi:** Diplomë fakulteti ose master në ekonomi, juridik, administratë publike, shëndetsi ose Inxhinieri;
- **Përvoja Profesionale:** Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim të jashtëm, si dhe tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- **Certifikimi:** Auditor i certifikuar ose Auditor i certifikuar i sektorit publik;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

3. Pozita: Drejtor i Departamentit për Metodologji në Auditim – një (1) pozitë

Numri i referencës:	DDMA/ZKA/10-11/24
Kohëzgjatja e emërimit:	Tre (3) vjet
Grada:	B5-12
Raporton tek:	Auditori i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1.1. Përditëson metodologjinë e brendshme në pajtim me standardet ndërkombëtare të SNISA-dhe ato të kontabilitetit;
- 1.2. Përcjellë praktikat dhe standardet ndërkombëtare lidhur me Institucionet Supreme të Auditimit si dhe informon të punësuarit e ZKA-së për ndryshimet dhe plotësimet e reja;
- 1.3. Harton dhe përditëson Doracakët e Auditimit dhe udhëzuesit për Kontrollin e Cilësisë në auditim si dhe letrat të punës;
- 1.4. Siguron përkrahjen e vazhdueshme dhe efektive për ekipet e auditimit përmes metodave më të avancuara të auditimit;
- 1.5. Zhvillon dhe realizon programet efektive të trajnimit për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive teknike për auditorët;
- 1.6. Ndihmon në implementimin e projekteve përkrahëse që ndërlidhen me menaxhimin e cilësisë;
- 1.7. Në bashkëpunim me njësitë tjera i propozon Auditorit të Përgjithshëm për miratim dokumentet strategjike dhe planet përkatëse;
- 1.8. Ofron udhëzime dhe këshilla për të punësuarit e ZKA-së në lidhje me standardet e auditimit.
- 1.9. Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së;
- 1.10. Raporton lidhur me rezultatet dhe ndikimin e punës në kuadër të departamentit.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- **Arsimimi:** Diplomë fakulteti ose master në ekonomi, juridik, administratë publike ose Inxhinierisë;
- **Përvoja Profesionale:** Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre se paku 5 vite në auditim të jashtëm, prej tyre tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- **Certifikimi:** Të jetë Auditor i certifikuar ose Auditor i certifikuar i sektorit publik.

4. Pozita: Drejtor i Departamentit për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analiza – një (1) pozitë

Numri i referencës:	DDPSRA/ZKA/10-12/24
Kohëzgjatja e emërimit:	Tre (3) vjet
Grada:	B5-12
Raporton tek:	Auditori i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1.1. Zhvillon dhe harton strategjinë gjithëpërfshirëse të ZKA-së;
- 1.2. Është përgjegjës për përgatitjen e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë dhe i raporton Auditorit të Përgjithshëm për progresin e arritur në lidhje me hartimin e planit të veprimit;
- 1.3. Jep këshilla për Auditorin e Përgjithshëm, që ndërlidhen me çështjet strategjike, si dhe ndihmon njësitë tjera organizative të ZKA-së për zbatimin e objektivave strategjike;
- 1.4. Monitoron zbatimin e strategjisë, si dhe rekomandon ndërmarrjen e masave për realizimin e strategjisë për njësitë organizative të ZKA-së;
- 1.5. Është përgjegjës për zhvillimin e Planit Vjetor të Punës dhe Planin Vjetor të Auditimit për ZKA-në;
- 1.6. Në bashkëpunim me departamentet tjera, në afatin e parapara kohor përgatit Raportin Vjetor të Performancës së ZKA-së;
- 1.7. Kryen analiza të Ligjit për ndarjet buxhetore dhe analiza të të dhënave tjera, dhe të njëjtat ju dorëzon ekipeve të auditimit dhe ekipit të Raportit Vjetor të Auditimit;
- 1.8. Mbledhë të dhënat e nevojshme për ekipet e auditimit, me theks të veçantë raportet periodike mbi buxhetin, të hyrat, shpenzimet dhe raportet tjera, si dhe kryen analizën dhe selektimin e të dhënave sipas nevojave të auditimit;
- 1.9. Në koordinim me përgjegjës të kryesor për hartimin e Raportit Vjetor të Auditimit, ndihmon ekipin e auditimit me analiza të ndryshme;
- 1.10. Raporton lidhur me rezultatet dhe ndikimin e punës në kuadër të departamentit; dhe
- 1.11. Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- **Arsimimi:** Diplomë fakulteti ose master në ekonomi, juridik, administratë publike ose Inxhinierisë;
- **Përvoja Profesionale:** Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre se paku 5 vite në auditim të jashtëm, prej tyre tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- **Certifikimi:** Të jetë Auditor i certifikuar ose Auditor i certifikuar i sektorit publik.

Procedura e Konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për punonjësit e Zyrës Kombëtare të Auditimit të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta për të gjithë punonjësit brenda Zyrës Kombëtare të Auditimit. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2024 për Pranim dhe Karrierë, Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës, si dhe Rregulloren (ZKA) Nr. 02/2024 për Organizim të brendshëm dhe Sistematizim të Vendeve të Punës.

Konkursi është i hapur pesë **(5) ditë pune** pas ditës së publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZKA-së dhe në tabelën e shpalljeve zyrtare, respektivisht duke filluar nga data **25.10.2024**. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **31.10.2024, ora 16.00**.

Formularët zyrtar për konkurrim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga në faqja e internetit e ZKA-së në adresën <http://www.zka-rks.org/> dhe dorëzohen në Departamentin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në adresën: Lagja: Arbëria, rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari konkurrues dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Aplikacionit duhet t’i bashkangjiten:

- Formularin zyrtar të ZKA-së për konkurrim.
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave për kualifikimet shkollore. Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopjet e kualifikimeve të tjera profesionale që lidhen me pozitën e punës;
- Dëshmitë për përvojën e punës të lëshuara nga organizata përkatëse – punëdhënësi;

Vetëm formulari zyrtar i konkurrimit do të merret parasysh. Formularët e konkurrimit të dorëzuar pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen.

Shënim:

Dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit të brendshëm e që janë pjesë e dosjes personale, mund të sigurohen në çdo kohë nga DMBNJ, sipas kërkesës së kandidatit.